



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr.
Nr. Dok.

Prot.

Tiranë ___/___/2020

Lënda : *Rekomandim për marrjen e masave të nevojshme për respektimin e lirisë kushtetuese të tubimit edhe gjatë gjendjes së jashtëzakonshme.*

KOMITETIT NDËRMINISTROR TË EMERGJENCAVE CIVILE
Tiranë

PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM
Z. Olsian Çela
Tiranë

MINISTRIT TË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
Zj. Ogerta Manastirliu
Tiranë

DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË POLICISË SË SHETIT
Drejtues Madhor Ardi
Veliu
Tiranë

Të nderuar,

Gjatë dy viteve të fundit, në institucionin e Avokatit të Popullit kanë ardhur për shqyrtim ankesa nga subjekte të ndryshëm, si persona fizikë dhe juridikë (OJF, sindikata, studentë, grupime qytetarësh, etj.) të cilët kanë pasur pretendime ndaj organeve të Policisë së Shtetit për mos lejimin e ushtrimit të lirisë për tubim. Sipas subjekteve ankuese, refuzimi nga organet e policisë është bërë për shkaqe nga më të ndryshmet, si për mos bërjen e njoftimit pranë organeve të policisë brenda afatit të parashikuar nga ligji, për mungesë të identitetit ose të adresës së organizatorit apo të drejtuesit të tubimit, për mos pasqyrimin në njoftim të qëllimit të tubimit, të datës, vendit, orës së fillimit dhe të përfundimit të tubimit apo të itinerarit të tij (nëse ka të tillë), të numrit të përafërt të pjesëmarrësve dhe numrit të personave ndihmës në mbarëvajtjen e tubimit, të identitetit të personave që do të flasin në tubim, etj.

Gjithashtu gjatë kësaj periudhe institucioni i Avokatit të Popullit ka filluar e ndjekur me nismën e vet disa raste të bëra publike në media për pengimin e ushtrimit të lirisë së tubimit, si dhe ka monitoruar pothuajse të gjitha tubimet e organizuara nga Partitë e Opozitës dhe grupime qytetarësh, të studentëve të organizuar në Tiranë, të banorëve tek "Unaza e Re",

zona e “Astirit” dhe në zonën pranë “Bregut të lumit” Tiranë, të cilët kanë protestuar respektivisht ndaj Institucioneve Publike të Arsimit të Lartë për kushte më të mira në universitete, për prishjet e objekteve të tyre për shkak të zbatimit të projektit të zgjerimit të “Unazës së Re” dhe të zgjatimit të Bulevardit “Zogu i Parë”.

Nga shqyrtimi i këtyre rasteve nga institucioni ynë është konstatuar se në një pjesë prej tyre :

1. Njoftimet e subjekteve për tubim janë refuzuar për arsye se vendi i kërkuar për tubim nuk ka qënë i përshtatshëm, pasi bëhej pengesë për lëvizjen normale të shtetasve dhe të automjeteve;

2. Përgjigjet e organeve të policisë për plotësimin e të dhënave, apo për refuzimin e tubimit nuk kanë qënë korrekte, por janë gjetur shkaqe të paqëndrueshme për të refuzuar njoftimet apo kthyer përgjigje me pretendimin se ato nuk plotësonin kriteret ligjore duke ndaluar ushtrimin e lirisë së tubimit të qytetarëve;

3. Drejtuesit e organeve të policisë (Shefat e Komisariateve), të cilëve iu drejtohen këto njoftime, nuk kanë nxjerrë vendime të arsyetuara për komunikim me organizatorin ose drejtuesin e tubimit për ndalimet dhe kufizimet e mundshme ose kushtet e tjera, duke përfshirë edhe numrin e personave që do të ndihmojnë në mbarëvajtjen e tij, sipas nenit 6/1/a të ligjit “Për Tubimet”¹, apo për ndalimin e tubimit në sheshe ose vendkalime publike, apo për përcaktimin e kohës dhe vendit të zhvillimit të tubimit, sipas nenit 8 të këtij ligji². Në këtë mënyrë, kërkuesve iu është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, pasi iu është mohuar e drejta për ankim ndaj vendimit të prishshëm të Shefit të Komisarariatit të Policisë, të parashikuar në nenin 25 të ligjit “Për tubimet”;

4. Strukturat qendrore dhe vendore të Policisë së Shtetit, kryesisht të Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, kanë shkelur parimin e proporcionalitetit nëpërmjet tejkalimit të forcës fizike të ushtruar ndaj qytetarëve dhe hedhjes së gazit lotsjellës më shumë se sa ka qënë e nevojshme, si dhe në ambientet e mbyllura.

Për rastet e sipërpërmendura janë bërë rekomandime drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit nëpërmjet të cilave kemi kërkuar respektimin nga strukturat e këtij organi të lirisë së tubimit, të lëvizjes së lirë, parimit të proporcionalitetit, të drejtës së informimit dhe të ofrimit të shërbimit dhe të lehtësimeve të nevojshme qytetarëve nga këto organe³.

¹ Neni 6 i ligjit nr. 8773, datë 23.4.2001, “Për Tubimet”, parashikon se:

“1. Shefi i Komisarariatit të Policisë, brenda 24 orëve nga marrja e kërkesës sipas pikës 2 të nenit 5, ose brenda 8 orëve nga marrja e kërkesës sipas pikës 3, të nenit 5, të këtij ligji me vendim të arsyetuar duhet:

a) t’i komunikojë organizatorit ose drejtuesit të tubimit ndalimet dhe kufizimet e mundshme ose kushtet e tjera, duke përfshirë edhe numrin e personave që do të ndihmojnë në mbarëvajtjen e tij,

b) t’u japë kopje të urdhrat zyrtar për caktimin e oficerit të policisë që do të jetë përgjegjës për të ndihmuar dhe vëzhguar zhvillimin e tubimit.

2. Shefi i Komisarariatit të Policisë njofton me shkrim drejtuesin e pushtetit vendor dhe prefektin për zhvillimin e tubimit”.

² Neni 8 parashikon se:

“Kur ka arsye të motivuar se zhvillimi i një tubimi në një shesh ose vendkalim publik përbën një rrezik real për sigurinë kombëtare, sigurinë publike, parandalimin e krimit, mbrojtjen e shëndetit ose të moralit ose mbrojtjen e lirisë dhe të drejtave të të tjerëve dhe ky rrezik nuk mund të ndalohet me masa më pak shtrënguese, shefi i komisarariatit të policisë mund të ndalojë zhvillimin e tubimit ose të vendosë për kohën dhe vendin e zhvillimit të tubimit”.

³ 1. Rekomandimi dërguar DPP Shtetit për: 1. “Marrjen e masave të nevojshme për përgatitjen e modelarëve tip, si “Njoftim drejtuar Komisarariatit të Policisë për zhvillimin e tubimit në sheshe ose vendkalime publike” dhe “Njoftim drejtuar Komisarariatit të Policisë për zhvillimin e tubimit urgjent në sheshe ose vendkalime publike” nga subjektet njoftuese, publikimin e tij në Website e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit me qëllim që të jetë i aksesueshëm për shtetasit dhe të krijojë mundësinë e aplikimit on-line prej tyre. 2. Marrjen e masave të nevojshme për përgatitjen e modelarëve tip, si “Vendim administrativ për komunikim me organizatorin ose drejtuesin e tubimit për ndalimet dhe kufizimet e mundshme ose kushtet e tjera, duke përfshirë edhe numrin e

Raporti i zgjerimit i Bashkimit Evropian për Shqipërinë për vitin 2019 në kapitullin e të drejtave themelore parashikon shprehimisht se liria e tubimit dhe organizimit janë shprehimisht të parashikuara në Kushtetutë dhe legjislacionin për tubimet dhe janë në përgjithësi në linjë me standartet ndërkombëtare si dhe me Rregullat Kuadër të ODHIR-it mbi të drejtën për tubime paqësore. Pavarësisht kësaj, ligji për tubimet nuk duket se adreson çështjen e tubimeve spontane dhe kundërprotestave. Gjatë periudhës së raportimit e drejta për tubime ishte përgjithësisht e garantuar, gjithsesi incidente u regjistruan në disa protesta dhe demonstrata politike⁴.

Nga ana tjetër, pas shpalljes së gjendjes së pandemisë botërore në datën 11 Mars 2020 nga Organizata Botërore e Shëndetësisë, nga ana e strukturave kompetente shtetërore u miratuan një sërë aktesh⁵ për marrjen e masave të veçanta administrative në përputhje me situatën, të cilat sollën kufizimin e disa të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese dhe ligjore.

Shpallja e kësaj gjendjeje në vendin tonë shkaktoi ndërprerjen e aktivitetit të përgjithshëm shoqëror dhe kufizimin e aktivitetit ekonomik. Për rrjedhojë, kjo situatë ka cenuar edhe nivelin e jetesës dhe të mirëqënies së qytetarëve, veçanërisht të disa kategorive shoqërore që janë në nevojë.

Pavarësisht kësaj gjendjeje, Institucioni i Avokatit të Popullit në vijimësi ka kryer detyrën në përmbushje të misionit të tij kushtetues, për mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve shqiptarë dhe të huaj që banojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë si edhe evidentimin e rasteve të ndryshme të mosrespektimit apo mosgarantimit të të drejtave themelore të njeriut, në atë masë që janë të pakufizueshme apo të pakufizuara nga aktet normative të nxjerrë për këtë qëllim.

Në këtë kuadër, nga ana jonë janë ndjekur me vëmendje nëpërmjet mediave protestat e qytetarëve të organizuara në qytete të ndryshme të vendit gjatë periudhës së pandemisë dhe vendosjes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore për shkak të përhapjes së infeksionit nga COVID-19. Nëpërmjet tubimeve ata kanë shprehur shqetësimet e tyre dhe i kanë bërë publike ato për të tërhequr vëmendjen dhe sensibilizuar opinionin publik.

Sipas mediave, në disa raste protestat janë organizuar nga punonjësit e ndërmarrjeve private për shkak të mos marrjes së “pagës së luftës”, në disa raste nga punonjës të ndërmarrjeve

personave që do të ndihmojnë në mbarëvajtjen e tij”, sipas nenit 6/1/a të ligjit “Për Tubimet” dhe “Vendim administrativ për ndalimin e zhvillimit të tubimit në sheshe ose vendkalime publike, apo për përcaktimin e kohës dhe vendit të zhvillimit të tubimit”, sipas nenit 8 të këtij ligji”.

2. Rekomandimi dërguar DPP Shtetit për: “Marrjen e masave për një qëndrim të drejtë dhe zbatim korrekt nga Policia e Shtetit të ligjit nr.8773, datë 23.4.2001, “Për Tubimet”, për të mos ndaluar apo kufizuar organizimin apo pjesëmarrjen e qytetarëve në tubimet paqësore me qëllim, respektimin e mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, si atë të tubimit ashtu edhe atë të lëvizjes së lirë”.

3. Rekomandimi dërguar DPP Shtetit për: “1. Zbatimin e parimit ligjor të proporcionalitetit kur përdoret gazi lotsjellës nga punonjës të policisë; 2. Analizimin e rasteve nga strukturat përgjegjëse për përdorimin e gazit lotsjellës dhe në Drejtoritë Vendore të Policisë”.

⁴ Progres Raporti i BE për Shqipërinë, <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-albania-report.pdf>, f.10

⁵ Akti normativ nr. 3, datë 15.3.2020, i Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”, i ndryshuar, VKM nr. 243, datë 24.03.2020, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, nxjerrja e një sërë aktesh normative nga Komiteti Ndërmnistror i Emergjencave Civile si organi më i lartë për koordinimin dhe bashkërendimin e veprimeve të institucioneve shtetërore dhe të subjekteve private, si dhe të burimeve financiare e materiale për përballimin e fatkeqësisë natyrore për shkak të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19, si dhe nga disa ministra kryesisht Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

private apo shtetërore për shkak të largimit nga puna, në disa raste nga banorë të cilët kanë pasur probleme të dëmtimit të banesave të tyre nga tërmetet e vitit të kaluar. Ndërsa në disa raste të tjera protestat janë organizuar nga aktivistë të shoqërisë civile dhe qytetarë të ndryshëm për shkak të masave kufizuese të vendosura nga autoritetet shtetërore gjatë kësaj periudhe të pandemisë.

Gjithashtu nga media jemi informuar se në disa raste gjatë zhvillimit të protestave kanë ndërhyrë strukturat e Policisë së Shtetit të cilat kanë bërë shoqërime në organet e policisë të organizatorëve dhe disa pjesëmarrësve në protestë, emë pas referimin e materialeve procedurale në organet e prokurorisë për veprat penale “

Organizimi dhe pjesëmarrja në grumbullime e manifestime të paligjshme” dhe “Prishja e qetësisë publike”, parashikuar nga nenet 262 dhe 274 të Kodit Penal. Raste të tilla janë evidentuar në qytetet e Tiranës, Fierit dhe Vlorës. Ndërsa në disa raste të tjera, nuk është dhënë ndonjë informacion për reagimin e Policisë së Shtetit dhe se çfarë veprimesh janë kryer nga strukturat e saj në lidhje me organizatorët dhe pjesëmarrësit të protesta.

Për të bërë të mundur vlerësimin e këtyre rasteve si dhe të sjelljes së strukturave të Policisë së Shtetit lidhur me trajtimin e tyre, duke mbajtur në konsideratë faktin se e drejta e shtetasve për tubim është një e drejtë themelore kushtetuese, me shkresën nr. K2/I18-2 prot., datë 18.05.2020 drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit kërkuam dërgimin e një informacioni lidhur me qëndrimin e mbajtur nga Policia e Shtetit në rastet e zhvillimit të protestave në qytete të ndryshme të vendit gjatë periudhës së shpalljes së pandemisë dhe të gjendjes së fatkeqësisë natyrore në vend. Gjithashtu i kërkuam të na informonte se si janë vlerësuar ato, çfarë veprimesh procedurale janë kryer me organizatorët dhe pjesëmarrësit në protesta dhe nëse është zbatuar i njëjti standard në të gjitha rastet.

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit me shkresën nr. 3144/1 prot., datë 02.06.2020, ndërmjet të tjerave na informoi se:

“Bazuar në nenin 7 “Masa të veçanta”, të ligjit nr.15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, gjermën “dh”, pika 6.1 të VKM nr. 243, datë 24.03.2020 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, Aktin normativ nr. 3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”, të ndryshuar, Urdhrit e Ministrisë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 132, datë 08.03.2020 “Për mbylljen e aktiviteteve publike dhe jopublike dhe anulimin e grumbullimeve masive në vende të mbyllura apo të hapura”, i ndryshuar, nenin 242/a të Kodit Penal, të ndryshuar, zhvillimi i aktiviteteve publike, si grumbullime, tubime e protesta në vende të mbyllura dhe të hapura, janë të ndaluara.

Megjithë përcaktimet ligjore të mësipërme, gjatë kohëzgjatjes së pandemisë COVID-19, janë evidentuar zhvillimi i disa grumbullimeve dhe tubimeve/protestave në vende të hapura dhe të mbyllura për publikun në disa qytete të vendit dhe konkretisht:

- 27 raste grumbullime/tubime e protesta në vende të hapura dhe të mbyllura për publikun.

- Proceduar dhe referuar në organet e prokurorisë për ndjekje penale për “Prishje të rendit e qetësisë publike”, “Organizimi dhe pjesëmarrja në tubim të paligjshëm”, parashikuar nga nenet 262 dhe 274 të Kodit Penal, në 21 raste.

- Grumbullime për të cilat nuk janë kryer veprime procedurale dhe referime në prokurori janë 6 raste (kryesisht të zhvilluara në qytetin e Vlorës nga shitësit e tregut të fruta-perimeve, punëtorë të Fasonerisë “Maks Shoes”, etj), në të cilat janë respektuar masat

e sigurisë ndaj COVID-19 dhe janë shpërndarë pasi një përfaqësuesi i tyre ka marrë takim me drejtues të tatimeve, Bashkisë dhe institucionit të Prefektit Vlorë.

- Grumbullime dhe tubime/protesta të paligjshme të cilat janë shoqëruar dhe me mosbindje dhe kundërshtim të punonjësve të Policisë së Shtetit, për të cilat janë kryer arrestime/ndalime të drejtuesve, organizatorëve e personave të tjerë pjesëmarrës janë 4 raste (në juridiksionin e DVP Tiranë).

- Grumbullime, tubime/protesta për të cilat janë kryer procedime penale në gjendje të lirë të drejtuesve, organizatorëve e personave të tjerë janë 17 raste.

- Në dy raste, organizatorët e grumbullimeve, tubimeve dhe parakalimeve në vende të hapura për publikun, në qytetin e Tiranës i janë drejtuar me kërkesë/njoftim zyrtar DVP Tiranë për zhvillimin e këtyre aktiviteteve, për të cilat nga ana e strukturave të DVP Tiranë u është kthyer përgjigje zyrtare duke u bërë me dije kushtet në të cilat gjendet vendi ynë (situata COVID-19) dhe aktet ligjore që ndalojnë zhvillimin e këtyre aktiviteteve.

- Me gjithë komunikimin zyrtar të zhvilluar me organizatorët e këtyre aktiviteteve për ndalimin dhe mos zhvillimin e tyre, personat janë grumbulluar dhe kanë zhvilluar aktivitetet e paligjshme, për të cilat janë kryer shoqërimet përkatëse dhe veprimet procedurale për ndjekje penale të lirë të organizatorëve/drejtuesve të këtyre aktiviteteve.

- Në të gjitha rastet Policia e Shtetit ka bërë me dije paligjshmërinë e zhvillimit të aktiviteteve të tilla në kushtet e pandemisë COVID-19, ka bërë thirrje për ndalimin e aktivitetit dhe shpërndarjen e pjesëmarrësve. Në rastet kur organizatorët dhe pjesëmarrësit nuk u janë bindur urdhrave dhe kërkesave të shërbimeve të Policisë së Shtetit, është ndërhyrë për ndërprerjen e aktivitetit, shpërndarjen e pjesëmarrësve, kryerjen e veprimeve procedurale dhe referimin e tyre në organin e prokurorisë”.

Ndërsa Drejtoria Vendore e Policisë (DVP) Tiranë me shkresën nr. 4065/1 prot., datë 12.06.2020 ndërmjet të tjerave na vuri në dijeni se:

“Me shkresën e datës 04.05.2020 të avokatit Altin Goxhaj është njoftuar se në datat 6 - 7 maj 2020, në orën 12:00, do të zhvillohej një tubim në Sheshin “Skënderbej”. Qëllimi i tubimit ishte kundër diktaturës, falimentimit ekonomik të Shqipërisë dhe burgut shtëpiak të shqiptarëve.

DVP Tiranë me shkresën nr. A153/1 datë 04.05.2020 i ka kthyer përgjigje organizatorit bazuar në gërmën “a” të nenit 6 të ligjit nr. 8773, datë 23.04.2001 “Për tubimet”, të ndalojë zhvillimin e tubimit të kërkuar nga ana e tij në orën 12:00 të datave 06-07 maj 2020 në vendin e përcaktuar në kërkesë, pasi në gërmën “dh”, pika 6.1 të VKM nr. 243, datë 24.03.2020 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, për shkak të epidemisë së shkaktuar nga Covid-19, është e përcaktuar se ndalohen tubimet, manifestimet dhe grevat. Gjithashtu organizatorit i është bërë me dije dhe rikujtuar se për veprime në kundërshtim me ligjin, organizatori, drejtuesi i tubimit dhe pjesëmarrësit në tubim, do të mbajnë përgjegjësi administrative dhe penale, në zbatim të gërmës “a”, neni 24 i ligjit nr. 8773, datë 23.04.2001 “Për tubimet”, si dhe nenit 262 të Kodit Penal “Organizimi dhe pjesëmarrja në tubim të paligjshëm”.

Për këtë tubim DVP Tiranë në bazë të Procedurës Standarde të Punës ka hartuar Planin e Masave nr. A-152/2 prot., datë 06.05.2020 “Për marrjen e masave, moslejimin e grumbullimit dhe zhvillimin e protestës së thirrur nga një grup qytetarësh më datë 07.05.2020, ora 12:00, te Sheshi “Skënderbej”.

Gjithashtu në këtë shkresë DVP Tiranë na informoi në lidhje me masat e marra për parandalimin e përhapjes së COVID-19, në Komisarariatet e Policisë, qoftë nga stafi, apo nga personat që shoqërohen në mjediset e komisariateve dhe konkretisht:

“Shoqërimi i personave në dhomat e shoqërimit është siguruar me mjetet e policisë duke respektuar Procedurën Standarde të Punës për “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, miratuar me Urdhrin nr. 938, datë 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Punonjësit e policisë kanë qenë të pajisur me maska mbrojtëse.

Në zbatim të Aktit normativ nr. 3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”, të ndryshuar, DVP Tiranë nga data 13.03.2020 mori masat duke pajisur punonjësit e policisë me maska respiratore, doreza plastike si dhe bërë dezinfektimin e të gjitha ambienteve të brendshme dhe të jashtme, mjedisëve, zyrave, sallat operative, dhomat e shoqërimit/sigurisë dhe mjetet lëvizëse të shërbimit.

Aktualisht vazhdon dezinfektimi në të gjithë mjediset e DVP Tiranë dhe në Komisarariatet e Policisë nga operatori ekonomik që ka lidhur kontratën me DVP Tiranë, me frekuencë dezinfektimi 1 herë në 7 ditë”.

Bashkëlidhur me informacionin DVP Tiranë na dërgoi edhe fotokopje të shkresës nr. A153/1 datë 04.05.2020, me lëndë: “Mbi ndalimin e tubimit sipas njoftimit tuaj të datës 04.05.2020” drejtuar avokat Altin Goxhaj, si dhe të Planit të Masave nr. A-152/2 prot., datë 06.05/2020 “Për marrjen e masave për moslejimin e grumbullimit dhe zhvillimin e protestës së thirrur nga një grup qytetarësh më datë 07.05.2020, ora 12:00, te Sheshi “Skënderbej”.

Në të dyja përgjigjet e përshkruara më sipër të dërguar institucionit tonë nga Drejtoria e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë evidentohet fakti se bazuar në Aktin normativ nr. 3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”, të ndryshuar; gërmën “dh”, pika 6.1 të VKM nr. 243, datë 24.03.2020 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”; Urdhrin e Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 132, datë 08.03.2020 “Për mbylljen e aktiviteteve publike dhe jopublike dhe anulimin e grumbullimeve masive në vende të mbyllura apo të hapura”, i ndryshuar, zhvillimi i aktiviteteve publike, si grumbullime, tubime e protesta në vende të mbyllura dhe të hapura, janë të ndaluara.

Në kuadër të trajtimit të kësaj çështjeje po i referohemi akteve normative në të cilat bazohen qëndrimet e Policisë së Shtetit për ndalimin e grumbullimeve, tubimeve, protestave, etj., gjatë periudhës së shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore për shkak të infeksionit COVID-19 dhe konkretisht:

1. Në Aktin normativ nr. 3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”, të ndryshuar, në nenin 3, pika 2 të tij parashikohet se:

“Subjektet apo individët që organizojnë zhvillimin e aktiviteteve publike dhe jopublike, si aktivitete sportive, kulturore dhe konferenca, apo grumbullimet masive në vende të mbyllura apo të hapura, si koncerte, tubime dhe dëgjesa publike, dënohen me gjobë në masën 5 000 000 (pesë milion) lekë për organizatorët dhe ndalimin e aktivitetit”.

2. Në VKM nr. 243, datë 24.03.2020 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, pika 6.1, gërma “dh”, parashikohet se:

“Institucionet publike të ndalojnë tubimet, manifestimet dhe grevat;”

3. Në Urdhrin e Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 132, datë 08.03.2020 “Për mbylljen e aktiviteteve publike dhe jopublike dhe anulimin e

grumbullimeve masive në vende të mbyllura apo të hapura”, i ndryshuar, pika 2, parashikohet se:

“Urdhëroj: anulimin e grumbullimeve masive në vende të mbyllura apo të hapura të tilla si koncerte, tubime dhe dëgjesa publike....”

Nga aktet e cituara më lartë, veçojmë Aktin normativ nr. 3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”, të ndryshuar, i cili është miratuar më pas me ligj nga Kuvendi brenda afatit të parashikuar nga Kushtetuta dhe që është akti me fuqi më të lartë nga të tre këto akte.

Nga përmbajtja e kësaj dispozite kuptohet në mënyrë të qartë se gjatë kohëzgjatjes së periudhës së pandemisë në vendin tonë të shkaktuar nga COVID-19 **ndalohen grumbullimet masive në vende të mbyllura apo të hapura, si koncerte, tubime dhe dëgjesa publike**, çka do të thotë se grumbullimet jo masive në vende të mbyllura apo të hapura, si koncerte, tubime dhe dëgjesa publike, nuk ndalohen.

Ndërsa, me Urdhrin nr.132, datë 8.3.2020, Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka urdhëruar mbylljen e aktiviteteve publike dhe jopublike të tilla si aktivitete sportive, aktivitete kulturore dhe konferenca, si dhe anulimin e grumbullimeve masive në vende të mbyllura apo të hapura të tilla si koncerte, tubime dhe dëgjesa publike.

Ky akt administrativ i cili nuk është mjaftueshëm i qartë nga pikëpamja e teknikës legjislative, duket se ka për qëllim kufizimin, ndalimin apo anulimin e disa të drejtave lidhur me aktivitetet publike dhe grumbullimet në vende të mbyllura dhe të hapura. Ai është interpretuar në mënyrë drastike nga autoritetet shqiptare si një ndalim tërësor e absolut i ushtrimit të të drejtave që kufizohen prej tij. Kufizimet e vendosura me këtë akt administrativ vijnë të zbatohen ende sot, kur kanë kaluar mbi 4 muaj nga fillimi i gjendjes së epidemisë në vendin tonë.

Sjellim në vëmendje se gjatë periudhës së pandemisë janë zhvilluar grumbullime, si takime, dëgjesa publike, etj., masive apo jo masive dhe me masa sigurie nga autoritete të ndryshëm të administratës publike si, ministra, kryetarë të bashkive etj., të cilat janë bërë publike edhe në media. Qëllimi i organizimit të tyre ka qenë lidhur me marrjen e masave mbrojtëse ndaj COVID-19, për zhvillimin e ekonomisë nëpërmjet turizmit, projekteve të ndryshme publike, promovime etj. Ndërkohë janë organizuar edhe aktivitete apo koncerte me një numër të reduktuar pjesëmarrësish/artistësh në ambiente të hapura në qytete të ndryshme të vendit. Sqarojmë se deri tani nuk kemi ndonjë informacion që në këto aktivitete dhe sidomos ato të organizuara në vende të hapura të jetë përhapur infeksioni COVID-19.⁶ Ndërsa nga ana tjetër grumbullimet apo protestat e qytetarëve të thjeshtë si një mjet për të realizuar të drejtën e tyre për të shprehur pakënaqësitë dhe opinionet e tyre, pavarësisht garantimit nga ana e tyre të rregullave të distancimit social, nuk janë lejuar.

Përsa rezulton më sipër, ne vlerësojmë se aktet normative të sipërpërmendura janë kuptuar, interpretuar dhe zbatuar jo në mënyrë të drejtë e korrekte nga ana e strukturave të Policisë së Shtetit. Për rrjedhojë ato kanë penguar dhe cenuar ushtrimin e një lirie-të drejte kushtetuese të shtetasve, sikurse është e drejta e tubimit.

⁶Shkresë e Institutit të Shëndetit Publik me Nr.496/1 prot, datë 29.04.2020 “Udhëzues për administratën/punët në zyrë dhe terren (COVID-19).

Qëndrimet jo ligjore të mbajtuara në këto raste nga organet e policisë cenojnë rëndë imazhin e Policisë së Shtetit dhe besimin e publikut tek ky organ, të cilat janë të domosdoshme në kryerjen me sukses të misionit ligjor të saj për ruajtjen e rendit dhe të sigurisë publike.

Avokati i Popullit shpreh qëndrimin e tij në lidhje me ushtrimin e të drejtës/lirisë së tubimit nga qytetarët si një nga të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Sjellim në vëmendje se liria e tubimeve është parashikuar dhe garantuar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Pjesa e II-të “Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut”, Kreu III “Liritë dhe të drejtat politike”, respektivisht në nenin 47 ku parashikohet se:

“1. Liria e tubimeve paqësore dhe pa armë, si dhe e pjesëmarrjes në to është e garantuar.

2. Tubimet paqësore në sheshe dhe në vendet e kalimit publik bëhen sipas procedurave të parashikuara me ligj”.

Liria e tubimit dhe e organizimit, garantohet edhe në nenin 11 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, ku shprehimisht thuhet se:

“1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së tubimit paqësor dhe të organizimit me të tjerët, duke përfshirë të drejtën e themelimit me të tjerë të sindikatave dhe të pjesëmarrjes në to për mbrojtjen e interesave të tij.

2. Ushtrimi i këtyre të drejtave nuk mund t’u nënshtrohet kufizimeve të tjera përveç atyre që parashikohen me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për ruajtjen e shëndetit ose të moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të tjerëve....”.

Kufizimet e vendosura ndaj të drejtave dhe lirive themelore të njeriut sikurse është dhe liria e tubimit nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut⁷ (KEDNJ) e interpretuar nëpërmjet Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), duke pararendur si kusht që këto kufizime të jenë proporcionale me gjendjen që e ka shkaktuar nevojën për vendosjen e tyre. Shteti ka diskrecion për të konstatuar domosdoshmërinë e kufizimit të një apo disa të drejtave në përputhje me rrethanat që diktojnë këtë nevojë, duke mbajtur në vëmendje deri në ç’masë është e nevojshme të vijohet me kufizimet në përpjekje për të kapërcyer gjendjen e emergjencës⁸.

GJEDNJ në praktikën e saj ka konsideruar se njoftimi, dhe madje procedurat e autorizimit, për një ngjarje publike normalisht nuk shkelin mbi thelbin e së drejtës në bazë të nenit 11 të Konventës për sa kohë që qëllimi i procedurës është që të lejojë autoritetet të marrin masa të arsyeshme dhe të përshtatshme për të garantuar zhvillimin normal të çdo tubimi, mbledhje apo grumbullimeve të tjera⁹. Organizatorët e tubimeve publike duhet të veprojnë në përputhje me rregullat që rregullojnë këtë proces duke respektuar rregulloret në fuqi. Njoftimi paraprak i shërben jo vetëm qëllimit të bashkërendimit të të drejtës së tubimit me të drejtat dhe interesat e ligjshëm duke përfshirë lirinë e lëvizjes të të tjerëve, por gjithashtu qëllimit të parandalimit të trazirave apo krimit. Edhe në rastin kur nuk është bërë një lajmërim paraprak

⁷ Neni 17 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

⁸ Me notën verbale të Misionit Permanent të RSH pranë Këshillit të Evropës, të datës 31 Mars 2020, shteti shqiptar, në përputhje me nenin 15/3 të KEDNJ, i ka njoftuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës derogimin nga disa të drejta të parashikuara nga nenet e Konventës, për shkak të gjendjes së epidemisë. Ndërkohë afati për të cilin është bërë derogimi ka rënë dhe aktualisht ai e ka humbur fuqinë ligjore.

⁹ Shih, *Sergey Kuznetsov kundër Rusisë*, nr. 10877/04, § 45, 23 tetor 2008.

për protestë, ky element teknik nuk duhet të shkelë kursesi thelbin e së drejtës për ta ushtruar lirinë e tubimit.¹⁰

Rregullat procedurale që disiplinojnë apo kushtëzojnë ushtrimin e kësaj të drejte janë të përcaktuara në mënyrë të shprehur në ligjin nr. 8773, datë 23.4.2001 “Për tubimet”, ku parashikohen edhe kufizimet apo ndalimet shteruese të cilat nuk mund të tejkalohen në ushtrimin e së drejtës së tubimit. Ky ligj pasi përcakton se, çdo person ka të drejtë të organizojë dhe të marrë pjesë në një tubim paqësor dhe pa armë, parashikon gjithashtu se Policia e Shtetit garanton dhe mbron të drejtën e çdo personi për të organizuar e marrë pjesë në tubime paqësore dhe pa armë. Ndalimi dhe shpërndarja e një tubimi lejohet vetëm në rastet e parashikuara me ligj. Nga referimi në përmbajtjen e dispozitave të këtij ligji rezulton në mënyrë të qartë se, detyrat e Policisë së Shtetit në lidhje me tubimet janë:

Së pari, veprime për garantim e ushtrimit të kësaj të lirie themelore kushtetuese të shtetasve dhe;

Së dyti, ndalimi i ushtrimit të kësaj të lirie/të drejte bëhet vetëm për raste të kufizuara dhe të përcaktuara qartë në ligj.

Për ushtrimin e kësaj të drejte kërkohet vetëm bërja e njoftimit në një kohë të përcaktuar i organeve të policisë ku të pasqyrohen disa të dhëna që lidhen me zbatimin e detyrës së saj si garantuese e ushtrimit të kësaj të drejte duke i dhënë kohe për të marrë masat e nevojshme për mbarëvajtjen e tubimit. Madje ligji aktual në nenin 7 parashikon edhe të drejtën e shtetasve për zhvillimin e tubimeve urgjente në rastet kur ka rrethana urgjente, i cili mund të zhvillohet pa respektuar afatin e parashikuar në nenin 5¹¹ të këtij ligji, por detyrimisht duhet të bëhet njoftimi me shkrim i cili përmban elementët e përcaktuar në nenin 5, pika 2 të këtij ligji, si dhe arsyen e urgjencës. Në këto raste njoftimi duhet të bëhet menjëherë, po jo më vonë se 3 orë përpara kohës së zhvillimit të tubimit.

Fakti që në ligjin aktual përdoret termi njoftim drejtuar Komisarariatit të Policisë për zhvillimin tubimit dhe jo kërkesë është me shumë rëndësi dhe domethënëse në favor të ushtrimit dhe garantimit të kësaj të drejte/lirie nga shtetasit. Nëse në këtë ligj do të parashikohej termi kërkesë për zhvillimin e tubimit, kuptohet në mënyrë të qartë se për të bërë të mundur ushtrimin e kësaj të drejte/lirie do të duhej miratimi i organit të policisë, sikurse ishte në ligjin e mëparshëm. Ndërsa përdorimi në ligj i termit njoftim, do të thotë që “vendimin” për ushtrimin e të drejtës e ka marrë vetë subjekti njoftues dhe nuk kërkohet miratimi i organit të policisë. Pikërisht këtu qëndron ndryshimi thelbësor që ka sjellë ligji i ri “Për tubimet” për të garantuar ushtrimin real të kësaj të drejte/lirie themelore kushtetuese të shtetasve në një vend demokratik sikurse është edhe vendi ynë. Nëse njoftuesit nuk e bëjnë njoftimin me të dhënat e parashikuara dhe kërkuara nga ligji, Shefi i Komisarariatit të Policisë ka të drejtën ligjore të komunikojë me organizatorin për plotësimin e të dhënave ose të marrë vendim të arsyetuar për ndalimin e tubimit në sheshe ose vendkalime publike, apo ndryshimin e vendit dhe të

¹⁰ Shih, *Éva Molnár kundër Hungarisë*, 7 tetor 2008, kërkesa nr. 10346/05.

¹¹ Në neni 5 të këtij ligji parashikohet se:

1. Në rast tubimi në sheshe ose vendkalime publike, organizatori dhe drejtuesi janë të detyruar të njoftojnë me shkrim shefin e komisarariatit të policisë jo më vonë se tri ditë para datës së zhvillimit të tubimit.

2. Njoftimi me shkrim duhet të përmbajë:

a) identitetin dhe adresën e drejtuesit dhe të organizatorit të tubimit;

b) qëllimin e tubimit;

c) datën, vendin, orën e fillimit dhe të përfundimit të tubimit dhe itinerarin e tij (nëse ka të tillë);

ç) numrin e përafërt të pjesëmarrësve dhe numrin e personave ndihmës në mbarëvajtjen e tubimit;

d) personat që do të flasin në tubim.

3. Në rast se njoftimi me shkrim nuk i përmban elementet e parashikuar në pikën 2 të këtij neni, ai i kthehet për plotësim organizatorit dhe drejtuesit të tubimit, të cilët duhet ta riparaqesin atë të plotësuar jo më vonë se 24 orë para kohës kur do të zhvillohet tubimi.

kohës së zhvillimit të tij. Është me rëndësi që të sjellim në vëmendje se fryma pozitive e ligjit aktual reflektohet në mënyrë të qartë edhe në nenin 12¹² të tij, ku parashikohet zhvillimi i tubimeve në vendet e hapura për publikun pa bërë njoftimin paraprak të policisë sipas nenit 5 të tij.

Përveç dispozitave të cituara më sipër, duke i referuar nenit 15/2 të Kushtetutës ku parashikohet se, “*Organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre*”, si dhe nenit 2 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” ku parashikohet se: “*Policia e Shtetit ka për mision ruajtjen e rendit e të sigurisë publike, ruajtjen e personaliteteve të larta shtetërore dhe objekteve të rëndësishme së veçantë, garantimin e zbatimit të ligjit, në përputhje me Kushtetutën dhe aktet ndërkombëtare, duke respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut*”, Avokati i Popullit vlerëson se nga organet e pushtetit publik kërkohet që, jo vetëm të mos bëhen pengesë për ushtrimin e lirisë së tubimeve të shtetasve, por përkundrazi duhet të kontribuojnë në realizimin e saj.

Po ashtu, metoda e përdorur nga policia për të dekurajuar pjesëmarrësit, duke e shpërndarë protestën është gjithashtu një faktor i rëndësishëm në vlerësimin e proporcionalitetit të ndërhyrjes. GJEDNJ e ka konsideruar shkelje të nenit 11 të Konventës Evropiane shpërndarjen nga policia të një tubimi paqësor mbi arsyetimin se ajo ishte mbajtur pa njoftim paraprak nga ana e organizatorëve.¹³ Sipas vendimit të kësaj Gjykate, megjithëse policia po vepronte në bazë të ligjit të brendshëm (ligj, i cili kërkonte që policia të informohet për një tubim të paktën tri ditë përpara si dhe po ashtu i jepte policisë autoritetin për të shpërndarë një tubim që zhvillohet pa njoftim paraprak), vendimi për të shpërndarë një tubim paqësor vetëm për shkak të dështimit të organizatorëve për të përmbushur një kërkesë për njoftim, pa ndonjë sjellje të paligjshme nga pjesëmarrësit, është një kufizim joproporcional në të drejtën për zhvillimin e një tubimi paqësor të parashikuar në nenin 11 të Konventës.

Në rastin konkret, të protestave në gjendjen e pandemisë, respektimi i parimit të proporcionalitetit në kufizimin e masave të marra do të kërkonte rishikimin e aktit administrativ apo zbatimin e tij në mënyrë të tillë që kufizimi i të drejtave të mos jetë absolut e as tërësor. Në çdo rast, kufizimet e vendosura duhet të jenë të tilla që të lidhen ngushtësisht me përballimin e situatës për parandalimin e përhapjes së sëmundjes, dhe në asnjë rast nuk mund të interpretohen si një asgjësim tërësor i së drejtës. Përkundrazi, masat e marra duhet të jenë të tilla që të përbëjnë kufizimin më pak të dëmshëm për të drejtat e kufizuara.

Nje problem tjetër i evintuar është se ne disa rasta e dhe gazetaret dhe reporteret jane ndaluar e shoqeruar duke e zbatuar statusin e raportuesit te ngjarjes me ate te organizuesit pjesemarrës.

Kufizimi absolut i të drejtës së qytetarëve për t’u mbledhur në kërkim të të drejtave të tyre, pra për t’u organizuar në tubime, ishte masë proporcionale në momentin e marrjes së një sërë masave të tjera për një interes më të lartë publik, por, që respektimi i këtij parimi të

¹² Në nenin 12 parashikohet se:

1. Tubimet në vende të hapura për publikun mbahen edhe pa njoftimin paraprak të policisë, sipas nenit 5 të këtij ligji.

2. Organizatorët e këtyre tubimeve mund të kërkojnë mbështetjen e policisë jashtë këtyre vendeve, për të mënjeluar ç'rregullimet gjatë ose pas zhvillimit të tubimit.

¹³ Shih, *Bukta dhe të tjerë kundër Hungarisë, nr. 25691/04*

garantohet edhe sot, duhet që të rishikohet domosdoshmërisht mënyra e zbatimit të kufizimit, apo e ndalimit.

Në këtë kuptim, një qasje korrekte edhe në respektim të Kushtetutës e të instrumentave ndërkombëtarë në fushën e të drejtave të njeriut do të ishte rishikimi i kësaj mase, duke lejuar ushtrimin e të drejtës për të tubuar, nën garancinë e rregullave strikte të përcaktuara nga autoritetet, ashtu, siç në fakt, po veprohet për shumë masa të tjera kufizuese.

Në vijim të këtij detyrimi dhe për t'u krijuar lehtësi shtetasve për realizimin e të drejtave të tyre kushtetuese e ligjore, por edhe për të unifikuar qëndrimin e organeve të Policisë së Shtetit, prokurorisë dhe atyre gjyqësore në të tilla raste, strukturat kompetente shtetërore duhet të përmirësojnë aktet normative që rregullojnë lirinë e tubimit, me qëllim që ajo të ushtrohet edhe në rastet e pandemive apo shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore. Gjatë procesit të përgatitjes së këtyre akteve të mbahen parasysh vendi se ku do të zhvillohet tubimi, i mbyllur apo i hapur, sipërfaqja e tij, numri i pjesëmarrësve, masat mbrojtëse ndaj përhapjes së infeksionit, parimi i rëndësishëm i proporcionalitetit, etj.

Lidhur me këtë çështje sjellim në vëmendje edhe qëndrimin dhe eksperiencën pozitive ndërkombëtare.

Raportuesi Special i Kombeve të Bashkuara për lirinë e tubimit dhe organizimit u është drejtuar të gjithë shteteve anëtare me një thirrje duke kërkuar prej këtyre të fundit që masat e marra ndaj COVID-19 të mos çenojnë lirinë e tubimit dhe organizimit¹⁴. Në rekomandimin adresuar shteteve anëtare janë listuar dhjetë parime e udhëzime themelore që shtetet duhet të mbajnë në konsideratë për të garantuar respektimin e kësaj të drejte dhe përfshirjen e shoqërisë civile e aktorëve të tjerë si partnerë në përballimin e krizës që po kalon çdo shtet¹⁵.

Ndër eksperiencat pozitive të shteteve evropiane në këtë drejtim mund të përmendim Gjermaninë, e cila gjatë periudhës së pandemisë ka lejuar zhvillimin e grumbullimeve dhe tubimeve deri në një numër të kufizuar pjesëmarrësish duke ruajtur distancimin fizik gjatë situatave të tilla. Gjykata Kushtetuese Gjermane është shprehur mbi të drejtën e personave për të zhvilluar protesta, nëse zbatojnë rregullat e distancës fizike në mënyrë që të pengojnë përhapjen e infeksionit COVID -19 duke theksuar se një ndalim i përgjithshëm i tubimeve do të ishte jokushtetues dhe se shqetësimet shëndetësore të lidhura me pandeminë e koronavirusit nuk janë bazë për një ndalim të përgjithshëm të protestave.¹⁶

Për sa më sipër, Avokati i Popullit në vijim të kryerjes së misionit ligjor *në rolin e nxitësit të standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend*, bazuar në nenin 63/3 të Kushtetutës ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*; si dhe nenin 21/b të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*,

¹⁴COVID-19 restrictions should not stop freedom of assembly and association, says UN expert <https://www.ohchr.org/EN/NewsEvents/Pages/DisplayNews.aspx?NewsID=25792&LangID=E>

¹⁵ States responses to Covid 19 threat should not halt freedoms of assembly and association” – UN expert on the rights to freedoms of peaceful assembly and of association, Mr. Clément Voule <https://www.ohchr.org/EN/NewsEvents/Pages/DisplayNews.aspx?NewsID=25788&LangID=E>

¹⁶ Federal Constitutional Court, April 15, 2020 – 1 BvR 828/20 https://www.bundesverfassungsgericht.de/SharedDocs/Entscheidungen/DE/2020/04/rk20200415_1bvr082820.html

REKOMANDOJMË¹⁷

1. Marrjen e masave të nevojshme për ndërprerjen e menjëhershme të praktikës së deritanishme të strukturave të Policisë së Shtetit për moslejimin e grumbullimeve jo masive në vende të mbyllura apo të hapura, si tubime dhe dëgjesa publike, organizuar nga subjekte të ndryshëm gjatë periudhës së kohëzgjatjes së pandemisë dhe të shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore.

2. Marrjen e masave të nevojshme nga strukturat përkatëse për të bërë propozimet konkrete drejtuar organeve që kanë të drejtën e nismës legjislative për të mundësuar ndryshimet në ligjin nr. 8773, datë 23.4.2001 “Për tubimet”, për të garantuar të drejtën e tubimeve spontane si dhe antiprotestat në përputhje me rekomandimet dhe aktet ndërkombëtare.

3. Marrjen e masave të nevojshme nga strukturat e Policisë së Shtetit për të garantuar të drejtën e ushtrimit të profesionit dhe raportimit të ngjarjeve nga gazetarët e pranishëm në tubime apo aktivitete të tjera të kësaj natyre.

4. Marrjen e masave të nevojshme nga strukturat e pushtetit publik për përmirësimin e akteve normative në fuqi që rregullojnë lirinë e tubimit me qëllim garantimin e kësaj të drejte kushtetuese edhe në periudha pandemie dhe të shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore, duke respektuar protokollat përkatës shëndetësorë.

5. Përgatitjen dhe miratimin e një udhëzimi apo qarkore nga Prokuroria e Përgjithshme, në bashkëpunim me KLP dhe KLGJ për unifikimin e praktikave të organeve të prokurorisë dhe ato gjyqësore për ndjekjen penale dhe gjykimin e çështjeve për veprën penale “Organizimi dhe pjesëmarrja në tubim të paligjshëm”, parashikuar nga neni 262 i Kodit Penal.

6. Marrjen e menjëhershme të masave nga Prokuroria e Përgjithshme për përgatitjen e propozimeve konkrete drejtuar strukturave kompetente me qëllim ndryshimin e nenit 262 të Kodit Penal në përputhje me frymën e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut si dhe praktikës së deritanishme të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi lutemi të na njoftoni brenda afatit ligjor prej 30 ditësh të parashikuar në nenin 22 të ligjit “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

AVOKATI I POPULLIT

ERINDA BALLANCA

¹⁷ Rekomandimet nuk u adresohen domosdoshmërisht të gjitha institucioneve të cilave u shkon ky dokument.